



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 22.17.1-2016-08

RAPORTI I AUDITIMIT

**PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË KOMUNËS SË
FERIZAJT PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të komunës së Ferizajt, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Florim Maliqi – udhëheqës ekipi, Mexhit Ferati, dhe Arben Hundozi, anëtar, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të auditimit Fatlinda Ramosaj.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
2 Qeverisja.....	11
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	17
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	34
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	35
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	38
Shtojca IV: Letër konfirmimi	44

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor të Komunës së Ferizajt për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit¹, të datës 21.10.2016.

Auditimi ynë është fokusuar në:



(Më hollësisht, shih Shtojcën 1)

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me Theksim të Çështjes

Sipas opinionit tone, Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i çështjes

Si Theksim të Çështjes dëshirojmë të përmendim faktin se pasuria e përvetësuar gjatë vitit 2016 në vlerë 542,569€ dhe 66 banesa të dhëna me qira, nuk ishin përfshirë në regjistrin e pasurisë dhe në PFV. Po ashtu, Komuna kishte bërë keq klasifikim të shpenzimeve në vlerë 401,042€, ku nga kategoria e investime kapitale kishte bërë pagesa 351,750€, të cilat i takojnë mallrave dhe shërbimeve dhe 49,292€ kishte bërë pagesa për subvencione ndërsa do të duhej të ishin transfere kapitale.

Formulimi i plotë i opinionit është dhënë në hollësi në kapitullin 1.1 të këtij raporti.

¹ Termi "Plani i Jashtëm i Auditimit" është zëvendësim i termit "Memorandumi i Planifikimi të Auditimit"


Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.


Dëshirojmë të falënderojmë Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore

Menaxhmenti i komunës ka dizajnuar sistemin e kontrollit të brendshëm, por këto kontrolle nuk kishin funksionuar në disa fusha të rëndësishme të menaxhimit financiar. Këto duhet në vazhdimësi të monitorohen për t'u siguruar se janë duke funksionuar siç duhet. Në vazhdim po i paraqesim fushat në të cilat janë vërejtur mangësi.

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:





Përgjigja e Kryetarit të komunës në auditimin 2016

Kryetari i Komunës ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit në këtë raport, si dhe është zotuar se do t'i adresojë rekomandimet e dhëna.

Ne e konsiderojmë si të kryer faktin që Kryetari:

- Do ta shqyrtojë raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- Deri në fund të muajit janar 2018, ta diskutoj në Asamblenë Komunale progresin lidhur me implementimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PFV-të 2017 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave.

Për më tepër shih shtojcën IV.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Ferizajt për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren e MF nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar të Organizatave Buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se komuna kishte bërë keq klasifikim të shpenzimeve ku nga kategoria e investimeve kapitale kishte bërë pagesa 251,750€, për realizimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor shtëpiak dhe funksionalizimit të kopshtit të fëmijëve i cili menaxhohet nga një OJQ të cilat i takojnë mallrave dhe shërbimeve. Po ashtu, shumat prej 100,000€ ishte paguar

direkt në llogari të donatorit në emër të përkrahjes dhe ngritjes së biznesve në komunën e Ferizajt. Këto shpenzime ishin aprovuar me tabelat buxhetore të Buxhetit 2016 si investime kapitale, por projektet e paraqitura në tabela, nuk përmbushin kushtet që të trajtohen si projekte kapitale, dhe 49,292€ kishte bërë pagesa për subvencione ndërsa do të duhej të ishin transfere kapitale. Gabimet kanë të bëjnë me planifikimet fillestare nga komuna dhe aprovimet jo adekuate nga ana e MF. Përveç kësaj, vlera e pasurive të regjistruara në regjistrin e pasurive dhe të prezantuara në PFV nuk ishin të plota pasi që komuna nuk ka arritur t'i regjistroj të gjitha pronat, përkatësisht 66 banesa të dhëna me qira dhe as pasurinë në vlerë 542,569€ të përvetësuar gjatë vitit 2016.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Kryetari i komunës së Ferizajt është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës dhe Zyrtares Kryesore Financiar janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq deklarim material kur ekziston. Keq deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Nëse PFV janë përgatitur brenda kornizës kohore dhe janë dorëzuar ne MF;
- Nëse Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit është dorëzuar me kohë; dhe
- Nëse Komuna kishte përgatitur dhe dorëzuar raporte të rregullta tremujore tek Kuvendi Komunal dhe një kopje tek MF.

Të gjitha kërkesat e lartshënuara janë përmbushur, por në draft Pasqyrat Financiare Vjetore janë vërejtur disa mangësi. Ne kemi dhënë disa sugjerime për të përmirësuar të dhënat në PFV dhe për të siguruar plotësinë e shpalosjeve të nevojshme. Disa korrigjime financiare të bëra janë si në vijim:

- Në pasqyrën e dytë - (ekzekutimi i buxhetit) të hyrat tatimore ishin prezantuar në shumë prej 1,978,000€ duke nënvlerësuar për (8,763€) si dhe të hyrat jo tatimore ishin prezantuar 2,163,000€ duke u nënvlerësuar për (19,371€);
- Shënimi 13 financimi nga huamarrja, vlera 50,000€ nuk është prezantuar tek buxheti final, dhe e njëjta nuk është shpalosur as tek shënimi shpjegues i shënimit 13 dhe neni 14.6;
- Te neni 16 për të arkëtueshmet ishte prezantuar shuma totale 6,988,230€. Korrigjimi i cili duhet të bëhet është tek llogaria e arkëtueshme për taksën në biznes e cila nuk prezanton shumën totale të të arkëtueshmeve 561,695€ (pa përfshirë borxhet nga vitet e kaluara);
- Llogaritë e arkëtueshme nuk kanë përfshirë shumën e borxheve nga vite me radhë në shumë 202,560€ (shoqata e dala nga Lufta);
- Donacionet në pasqyrën e dytë ishin prezantuar në shumë prej 132,000€ deri sa shuma e saktë ishte 105,586€;
- Neni 14 Raporti i ekzekutimit të buxhetit, në kolonën e buxhetit fillestar, dalja e parasë së gatshme për mallra dhe shërbime dhe shpenzime komunale ishin prezantuar sipas vlerës së buxhetit të rishikuar;

-
- Neni 19 Përmbledhja e pasurive jo financiare mbi 1,000, nuk janë dhënë shpalosje për rritjen e vlerës së pasurive, veçanërisht vlerës së tokës e cila ka një rritje prej 754,460€ krahasuar me vitin paraprak; dhe
 - Te neni 19.3.2 pasuritë jo kapitale nën 1,000€ në vitin 2016 nuk janë paraqitur fare.

Në PFV finale ende kanë mbetur gabime që kanë të bëjnë me:

- Shpalosja e llogarive të arkëtueshme sidomos për taksën në biznes dhe të qirasë nuk ishin korrigjuar; dhe
- Përmbledhja e pasurive jo financiare mbi 1,000€ nuk ishte e plotë. Këtë çështje më gjerësisht e kemi trajtuar tek nënkapitulli 1.1 Opinioni auditimit.

DEKLARATA E BËRË NGA MENAXHMENTI I KOMUNËS

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të draft PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet pjesërisht e saktë për shkak se gjatë auditimit ishin identifikuar gabimet dhe mangësitë e identifikuara si më lart.

1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

Për çështjet e sipër përmendura jepet rekomandimi

Rekomandimi 1 Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes së Opinioni. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i evituar gabimet në keq klasifikimin e shpenzimeve dhe mos regjistrimin e saktë të pasurive. Gjithashtu, duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha çështjet e ngritura në raport dhe Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për menaxhmentin e komunës që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit, pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollat. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vet-vlerësimit që plotësohet nga OB-të siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një OB të jenë të mbështetura me dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të nxisin përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda komunës veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Lista kontrolluese e vet-vlerësimit, e plotësuar nga komuna, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht, duke iu përgjigjur shumicës së pyetjeve me notë maksimale 3, që nuk bazohen në dëshmi. Vetëvlerësimi duhet të jetë më kritik ndaj arritjes së rezultateve.

Një ndër elementet kyçe të një qeverisje efektive të komunës është edhe zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga auditimi i jashtëm. Auditimi i këtij viti ka nxjerrë në pah se niveli i rekomandimeve të zbatuara nga viti i kaluar ishte i ulët, dhe vetëm 6 nga 21 rekomandime ishin implementuar.

Komuna ka një strategji zhvillimore, por kjo strategji nuk përfshinë llogaritjen e kostove për matjen e rezultateve të objektivave të saj. Edhe pse komuna konsideron që është marrë parasysh edhe kosto, ne nuk kemi gjetur dëshmi që ta mbështesim këtë pohim.

Përveç një plani emergjent, komuna nuk kishte përgatitur një listë të rreziqeve të cilat janë kërkesë e procedurave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti jonë i auditimit për PFV-të 2015 ka rezultuar me 21 rekomandime. Komuna e Ferizajt ka përgatitur dhe dorëzuar me kohë Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga viti paraprak. Raporti ynë ishte diskutuar edhe në Kuvendin Komunal. Deri në përfundim të auditimit 2016, gjashtë (6) rekomandime ishin zbatuar, shtatë (7) ishin në proces të zbatimit dhe tetë (8) nuk ishin zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shih Shtojcën III.

Çështja 2 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

E gjetura Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë zbatuar sepse menaxhmenti nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të AP.

Rreziku Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare kyçe kanë rezultuar në:

- Regjistrim jo të plotë të pasurive;
- Përsëritje të keq klasifikimit të shpenzimeve kapitale;
- Dobësive lidhur me të arkëtueshmet nga qiraja;
- Dobësi në hartimin e listës së rreziqeve;
- Dobësi të vazhdueshme në shpenzimet përmes prokurimit dhe vlerë të dobët për paranë; dhe
- Përfitim të limituar nga puna e Auditimit të Brendshëm.

Rekomandimi 2 Kryetari duhet të sigurojë se do të zbatohet një proces i forcuar i llogaridhënies së stafit përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve, sipas afateve kohore dhe prioriteteve të përcaktuara me planin e veprimit. Monitorimi i progresit të rekomandimeve duhet të bëhet në mënyrë sistematike.

2.2 Pyetëtori i vet-vlerësimit të komponentave të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vetvlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese. Ne kemi përmbledhur më poshtë të gjeturat tona për komunën, të cilat nuk kanë për qëllim të ofrojnë komente për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vet-vlerësimit, por pasqyrojnë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 3 – Pyetëtori i vet-vlerësimit – Prioritet i lartë

E gjetura Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësorit të vetvlerësimit në lidhje me pesë komponentët. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

1. Pyetëtori i vetvlerësimit i plotësuar nga stafi komunal ka dëshmuar se komuna ende nuk ka hartuar listën e rreziqeve të cilat mund të ndodhin dhe të cilat mund të ndikojnë në arritjen e objektivave;
2. Proceset efektive të monitorimit si dhe strategjia gjithëpërfshirëse e zhvillimit (përfshirë ndërlidhjen me palët e interesit si dhe sigurimin e strategjisë me kosto të plotë) konsiderohen si të vendosura nga komuna, mirëpo dëshmitë në mbështetje të këtyre konkluzioneve janë të dobëta. Çështjet e monitorimit, po ashtu, janë shqyrtuar më hollësisht nën kapitullin 2.4; dhe
3. Auditimi i Brendshëm nuk i ka theksuar çështjet më lart. Për më shumë, veprimi i ndërmarrë për adresimin e çështjeve të identifikuara nga vetvlerësimi i vitit 2015 është i limituar. Kjo situatë ka ndodhur për shkak të mungesës së qartësisë brenda komunës që ka të bëjë me rëndësinë e kësaj liste kontrolluese dhe me atë se kush është zyrtari përgjegjës që i përdorë këto mekanizma për t'i mbështetur përmirësimet operative.

Rreziku Mungesa e hartimit të listës së rreziqeve dhe mënyra e menaxhimit të tyre shpalosin dobësi në qeverisje, dhe si të tilla reduktojnë mundësinë e menaxhmentit për të reaguar me kohë ndaj rreziqeve të mundshme.

Rekomandimi 3 Kryetari duhet të sigurojë se është rishikuar plotësimi i listës kontrolluese të vetvlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë proaktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës. Ne do të sugjerim që lista kontrolluese të mos i dorëzohet MF-së para se të rishikohet nga auditimi i brendshëm.

2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit komuna operon dhe sfidat me të cilat përballet.

2.3.1 Përcaktimi i objektivave strategjike

Komuna e Ferizajt është e obliguar të përgatisë dhe të përcjelle planet strategjike në nivel të organizatës, si: planet urbanistike, hapësinore, plani operativ emergjent, plani strategjik kundër korrupsionit, strategjia e zhvillimit rajonal etj.

Komuna ka hartuar një sërë dokumentesh strategjike si: Plani urbanistik; Planin zhvillimor komunal dhe planin afat mesëm zhvillimor 2014-2021.

Çështja 4 - Planet strategjike - Prioritet i lartë

E gjetura Komuna ka një strategji të përgjithshme të zhvillimit, por nuk ka qartësuar përgjegjësitë për koordinimin dhe zhvillimin e planit strategjik, si dhe mungon llogaritja e kostove të strategjisë. Sipas komunës është bërë llogaritja e kostove për realizimin e kësaj strategjie, mirëpo ky pohim nuk ishte mbështetur me dëshmi përkatëse.

Komuna ka një plan të hartuar kundër korrupsionit, por kërkesat nga ky plan ende nuk kanë filluar të adresohen.

Rreziku Paqartësia mbi zbatimin e strategjisë, bën të pamundur të përcillet përmbushja e objektivave në pikëpamje të vizionit të Komunës, si një ndër kushtet esenciale të qeverisjes së mirë.

Rekomandimi 4 Kryetari duhet hartoj planin e veprimit për monitorimin e arritjes së objektivave duke vendosur funksione efektive të mbikëqyrjes. Të sigurojë se plani i përpiluar kundër korrupsionit do të zbatohet sipas kërkesave, dhe si i tillë do të bëhet funksional për një qeverisje më efektive.

2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara. Lidhjet në mes të planit të prokurimit dhe buxhetit si dhe përpilimi i raporteve adekuate në baza të rregullta kohore konsiderohen si të vendosura nga komuna dhe dëshmitë që na janë dhënë e mbështesin deri diku këtë konkluzion, edhe pse raportet nuk janë përpiluar gjithmonë në baza të rregullta kohore.

Çështja 5 - Dobësi në kontrollet menaxheriale - Prioriteti i lartë

- E gjetura** Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të komunës ka nxjerrë në pah një raportim të dobët financiar mbi shpenzimet, të hyrat dhe të arkëtueshmet tek menaxhmenti i lartë, si dhe analiza të pakompletuara të ofrimit të shërbimeve. Kjo ka ndodhur për shkak se formati i raporteve menaxheriale nuk ofron shpjegime rreth variancave në buxhet dhe se parashikimet buxhetore nuk janë azhurnuar në baza mujore. Ngjashëm, synimet operationale nuk menaxhohen në mënyrë sistematike.
- Rreziku** Cilësia e dobët e raportimit financiar dhe të aktiviteteve tek menaxhmenti i lartë e ka reduktuar aftësinë e menaxhmentit për të menaxhuar aktivitetet e komunës në mënyrë pro aktive si dhe ka ulur efektin e kontrolleve buxhetore. Kjo mund të rezultojë në deficit ose suficit të paplanifikuar dhe të vonojë veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato. Kjo, gjithashtu, mund të ndikoj që të hyrat të mos arkëtohen në nivelin e pritur.
- Rekomandimi 5** Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme deri në fund të vitit 2017.

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me dy anëtarë të stafit dhe drejtori i NJAB. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja sistematike e një Komiteti efektiv të Auditimit. Auditimet janë kryer në pajtim me planin strategjik dhe vjetor që janë aprovuar nga Kryetari i Komunës. Sipas planit vjetor të auditimit të NJAB, për vitin 2016 ishin planifikuar të realizohen 12 auditime, dhe ishin finalizuar të gjitha, si dhe dy (2) auditime me kërkesë ad hoc të Kryetarit të Komunës.

Çështja 6 - NJAB dhe komiteti i auditimit - Prioriteti i lartë

E gjetura Prej auditimeve të kryera nga NjAB, tre (3) ishin për vitin 2015 (shpenzimet, të hyrat), ndërsa tjerat për periudhën tetë (8) mujore të vitit 2016. Për të gjitha auditimet e kryera NjAB kishte dhënë 35 rekomandime ndërsa ishin implementuar vetëm dhjetë (10) nga to.

Komiteti i auditimit sipas kërkesave ligjore deri më tani ka mbajtur katër mbledhje të rregullta. Sipas UA Nr.11/2010 Komiteti i auditimit duhet që në fund të vitit të përgatisë raportin vjetor të punës dhe ta dorëzoj tek menaxhmenti i lartë. Ne nuk kemi gjetur se komiteti ka përgatitur këtë raport vjetor.

Rreziku Mos adresimi i rekomandimeve të dhëna nga NjAB, rritë rrezikun që dobësitë e identifikuar të mos korrigjohen, ndërsa mungesa e një raporti vjetor të punës se komitetit të auditimit ka ndikuar që menaxhmenti të mos hartoj planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve të dhëna nga NJAB.

Rekomandimi 6 Kryetari duhet të siguroj ndërmarrjen e veprimeve për zbatimin e rekomandimeve të NjAB nga drejtoritë përgjegjëse të sistemeve të audituara, dhe po ashtu, të siguroj se Komiteti i auditimit i respekton kërkesat ligjore për raportimin vjetor.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin 2, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore, si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Për komunën, prokurimi mbetet ndër shqetësimet kryesore, për shkak se rregulloret nuk janë aplikuar si duhet, dhe kjo ka rezultuar në vlerë të dobët për para. Numri i madh i aneks kontratave përshkruan më së miri dobësitë në planifikimin e prokurimit, pastaj mos respektimi i procedurave të prokurimit, pagesa e komunalive si paradhënie, etj. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat, në përgjithësi, janë më të mira, por kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar komunën që mos të pësoj dëme buxhetore. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë pagesat në emër të bashkëfinancimeve, keq klasifikimi i shpenzimeve, menaxhimi i dobët i pasurive si dhe mbledhja e të arkëtueshmeve, sidomos nga qiraja.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar të hyrat e arkëtuara, burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Pranimet	2015 Pranimet	2014 Pranimet
Të hyrat vetjake	4,160,320	4,151,609	4,199,493	3,511,999	3,575,464

Në vitin 2016, plani i të hyrave ishte realizuar 101%, për dallim nga viti 2015 ku të hyrat ishin mbledhur 84%, ndërsa në vitin 2014 plani ishte realizuar 94%. Pra, në vitin 2016 realizimi i të hyrave vetjake ka shënuar një rritje krahasuar me vitin paraprak prej 17%. Të hyrat përfshirë edhe ato të bartura nga viti paraprak, ishin shpenzuar kryesisht për projekte kapitale në shumë 2,364,407€, për mallra dhe shërbime në shumë 745,490€, si dhe për subvencione dhe transfere në shumë 640,087€.

Tabela 2. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Burimet e Fondeve:	25,285,097	26,942,875	25,258,562	25,128,033	24,438,363
Granti i Qeverisë -Buxheti	21,124,777	21,444,255	21,376,372	21,518,601	21,087,390
Të bartura nga viti paraprak ³ -	0	1,137,728	729,319	766,119	506,743
Të hyrat vetjake ⁴	4,160,320	4,151,609	3,020,666	2,597,871	2,661,098
Donacionet e brendshme	0	126,257	111,416	179,049	118,388
Donacionet e jashtme	0	33,026	20,789	66,393	64,744
Huamarrje (garancion)	0	50,000	0	0	0

Buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar ishte më i lartë për 1,657,778€. Ky ndryshim ka ardhur si rezultat i rritjes së Grantit Qeveritar prej 319,478€, të hyrave të bartura nga viti i kaluar 1,137,728€, të hyrave nga donacionet e brendshme dhe të jashtme 159,283€, si dhe huamarrje (garancion bankar) në fund të vitit 2016 në shumë 50,000€, ndërsa të hyrat vetjake me rishikim ishin zvogëluar për 8,711€.

Realizimi i buxhetit në vitin 2016 ishte 25,258,562€ ose 94% nga buxheti final deri sa në vitin 2015 ishte shpenzuar 93% si dhe në vitin 2014 ishte shpenzuar 94%. Në përgjithësi, komuna ka treguar një nivel të pranueshëm të performancës buxhetore, përveç kategorisë së investimeve kapitale.

Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	25,285,097	26,942,875	25,258,562	25,128,033	24,438,363
Pagat dhe Mëditjet	14,068,986	14,399,950	14,323,589	14,016,218	13,107,042
Mallrat dhe Shërbimet	2,806,828	2,998,183	2,993,220	1,466,867	1,919,774
Shërbimet komunale	452,680	533,117	532,052	433,656	400,854
Subvencionet dhe Transferet	599,752	670,226	659,232	693,127	726,996
Investimet Kapitale	7,356,851	8,341,399	6,750,469	8,518,165	8,283,697

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

³ Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

- Buxheti për investime kapitale në vitin 2016 ishte rritur për 984,548€. Niveli i ekzekutimit të buxhetit final ishte 81%. Shpenzimet kapitale kanë shënuar një ulje për 1,767,696€ krahasuar me vitin 2015. Programi për Investime Publike përfshin disa projekte në vazhdim nga viti i kaluar dhe projekte të reja për vitin aktual. Komuna nuk mban evidencë se cilat projekte janë finalizuar nga viti paraprak dhe viti aktual;
- Rritja e buxhetit për paga dhe mëditje për 330,964€ është rezultat i pagesave për përvojën e punës si dhe pagesave për kujdestari në shëndetësi;
- Rritja e buxhetit tek kategoria për mallra dhe shërbime në shumë 191,355€ ishte bërë për shkak të obligimeve të mbetura nga vitit paraprak dhe pagesa e tyre. Pavarësisht rritjes së buxhetit në fund të vitit komuna, ka hyrë në obligime në shumë 978,646€, duke tejkalluar ndarjet buxhetore;
- Buxheti për komunalitet ishte rritur për 80,437€ për shkak të pagesave për obligimet e mbetura. Mirëpo, në fund të vitit 2016 obligimet e papaguara ishin 96,9240€ duke tejkalluar ndarjet buxhetore;
- Buxheti për subvencione dhe transfere është rritur për 70,474€ për shkak të nevojave për ndihmë për entitetet jo publike. Në fund të vitit 2016 kishte mbetur si obligime të papaguara ndaj përfituesve individual shumë prej 2,014€;
- Donacionet e brendshme ishin 126,257€ si dhe ato të jashtme 33,026€. Donacionet e brendshme kryesisht ishin shfrytëzuar si participim në bujqësi si dhe në investime kapitale, ndërsa donacionet e jashtme ishin shfrytëzuar kryesisht për investime kapitale dhe një pjesë për mallra dhe shërbime; dhe
- Një alokim prej 50,000 nga të hyrat vetjake për përfitimin e një huaje nga MF.

Çështja 7 – Realizimi i buxhetit – Prioriteti i lartë

E gjetura	Komuna ka treguar një nivel të pritur të realizimit të buxhetit pothuaj se në të gjitha kategoritë e shpenzimeve. Mirëpo, një ngecje në krahasim me kategoritë tjera vërehet për investime kapitale (81%). Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së planifikimit dhe kontrollit sistematik buxhetor të komunës në realizimin e projekteve kapitale sipas planit dinamik.
Rreziku	Mosrealizimi i buxhetit sipas projeksioneve fillestare do të rezultojë në mos arritjen e objektivave të komunës dhe në financimin e projekteve dhe detyrimeve të vitit aktual nga buxheti i vitit të ardhshëm.
Rekomandimi 7	Kryetari duhet të siguroj dhe të përcaktoj objektiva të qarta për përmirësimin e planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit në periudhat e ardhshme, dhe të vendosë një monitorim sistematik mbi ekzekutimin e buxhetit të planifikuar, sidomos për projektet kapitale.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e gjithmbarshme në komunën e Ferizajt për vitin 2016 ishin 4,199,493€. Prej tyre 3,770,555€ janë mbledhur nga komuna ndërsa 428,938€ janë të hyra nga gjobat e trafikut, gjykatat dhe agjencia pyjore.

Komuna ka vendosur një gamë kontrollesh për inkasimin e të hyrave vetjake, por këto kontrolle duhet të forcohen dhe monitorohen në mënyrë sistematike për të dhënë rezultatin e pritur.

Çështja 8 - Mos regjistrimi i tatimit në pronë - Prioritet i lartë

E gjetura Me rastin e testimit të dhjetë (10) mostrave kemi gjetur se në një (1) rast një faturë për tatim në pronë ishte ngarkuar gabimisht në shumë 110,650€. Në kohën e auditimit kjo shumë është rregulluar dhe shuma e saktë e tatimit në pronë për këtë tatim pages ishte 54,533€.

Rreziku Fakti se zyra për tatim në pronë nuk ka rifreskuar të dhënat në sistemin e tatimit ka pasur si rezultat gabimin financiar duke mbingarkuar llogarinë e tatimpaguesit.

Rekomandimi 8 Kryetari duhet të ndërtoj mekanizëm kontrolli në mënyrë që të parandaloj gabimet. Po ashtu, të kërkojë nga zyra për tatim në pronë një përkushtim më të madh në rastin e ngarkesave si dhe të kërkojë raporte periodike me informata të sakta dhe të besueshme.

Çështja 9 - Mos aplikimi i interesit për taksë në firmë - Prioritet i lartë

E gjetura Për vitin 2016 komuna ka ngarkuar taksën në firmë për biznese në shumë 645,218€, deri sa të hyrat e inkasuara për vitin 2016 ishin 207,228€ apo 32% nga plani. Me rastin e testimit të pesë (5) mostrave kemi vërejtur se komuna nuk aplikon interesin prej 12% në vit për vonesë të pagesës nga tatimpaguesit, edhe pse në faturim ekziston kjo normë e interesit.

Rreziku Komuna nuk ka zbatuar kërkesat e saj ndaj tatimpaguesve për taksën në firmë. Mos zbatimi i interesit në rastin e pagesave ndikon që të hyrat e komunës nga taksë e biznesit të jenë më të ulëta.

Rekomandimi 9 Kryetari duhet të analizoj shkaqet për inkasim kaq të ulët dhe të krijoj mekanizma për rritjen e inkasimit. Duhet, po ashtu, të siguroj se interesi në vonesa për ngarkesën e taksës në firmë zbatohet ndaj të gjithë debitorëve.

Çështja 10 – Mungesa e plotësimi të formularit për leje ndërtimi – Prioritet i lartë

- E gjetura** Sipas të dhënave të Thesarit të hyrat për leje ndërtimi për periudhën vitin 2016 ishin 538,617 €. Ne nuk kemi gjetur se drejtoria e inspektimit ka përgatitur ndonjë raport për punën e tyre. Me rastin e testimit të tetë (8) rasteve për leje ndërtimi kemi gjetur se as për ato të ndërtimit kolektiv, e as për shtëpi banimi, formulari nuk është plotësuar nga inspektorët e komunës. Ne nuk kemi gjetur në asnjë nga rastet e testuara dëshmi se inspektorët përcjellin punimet nëse projektet realizohen në pajtim me lejet e ndërtimit.
- Rreziku** Mos përcjellja e punimeve nëse kushtet e ndërtimit po zbatohen sipas lejeve të lëshuara nga komuna, përkatësisht mungesa e mbikëqyrjes nga inspektorët komunal të ndërtimit, rrit rrezikun që investitori t'i shmanget kriterëve të ndërtimit.
- Rekomandimi 10** Kryetari duhet të analizoj performancën e dobët të kontrolleve lidhur me inspektimet në terren dhe të siguroj se kontrollet në zbatimin e lejeve ndërtimore do të aplikohen, si dhe të përgatiten raporte për punët e kryera nga zyrtarët përgjegjës.

Çështja 11 – Mangësi në evidencë për të hyrat nga kadastri – Prioritet i mesëm

- E gjetura** Zyrtari përgjegjës nuk mbanë evidencë për të gjitha pagesat e bëra në kadastrë. Ne me rastin e testimit të të hyrave nga kadastri, përkatësisht të 13 rasteve, kemi vërejtur se zyrtari nuk ka përgatitë ndonjë procesverbal me shkrim për dy rastet kur janë të liruar nga pagesa.
- Rreziku** Mungesa e evidencës për të gjitha pagesat nga kadastri si dhe mos përgatitja e ndonjë procesverbali për rastet e liruara, rrit rrezikun që menaxhmenti të mos ketë njohuri sa janë këto të hyra dhe sa raste janë liruar në bazë të rregullores përkatëse.
- Rekomandimi 11** Kryetari duhet të siguroj se zyrtarët përgjegjës mbajnë evidencë për të gjitha të hyrat dhe se rastet e liruara nga obligimi i pagesës së taksave të prezantohen veçmas në një evidence të veçantë.

Çështja 12 - Mos arkëtimi i qirasë nga prona publike - Prioritet i lartë

E gjetura Për testimin e të hyrave nga qiraja kemi marrë 13 mostra në shumë 24,710€. Rast specifik nga mostrat e testuara ishte qiramarrësi i parkingjeve "Shoqata e dalë nga lufta" e cila për çdo muaj ngarkohet nga komuna me 3,000€ deri sa qiramarrësi nuk ka paguar asnjë cent për vitin 2016 e as në vitin paraprak. Komuna nuk ka marrë ndonjë veprim as në vitin e kaluar as në këtë periudhë të auditimit. Faturat për këtë qiramarrës nuk shpërndahen apo nuk dorëzohen në zyrën e shoqatës. Komuna nuk ka ndonjë strategji për arkëtimin e qirasë nga shfrytëzimi i pronës publike.

Rreziku Menaxhimi i dobët i kontratave në lidhje me pronat e dhëna me qira si dhe mos gatishmëria për të ndërmarrë masa efikase për inkasimin e të hyrave, rrisin rrezikun e keqpërdorimit të pronës publike. Vetëm për këtë periudhë raportuese, komuna ka humbje financiare prej 36,000€ për vitin 2016, deri sa shuma totale e pa arkëtuar nga qiramarrësi në fjalë ishte 202,560€.

Rekomandimi 12 Kryetari i Komunës duhet ta shqyrtoj rastin pse qiraja e kontraktuar nuk po paguhet, si dhe ta informoj Kuvendin për problemet eventuale me qiramarrësin. Pasi të sigurojë një analizë të detajuar, të propozoj masat e duhura, duke mos i përjashtuar edhe masat gjyqësore dhe ato administrative (nëse ka nevojë).

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe Mëditjet paguhën përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat kyçe që e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave janë: a) autorizimi i listës së pagave; b) verifikimi i ndryshimeve të mundshme dhe c) rishikimi buxhetit për këtë kategori si dhe barazimi me Thesarin. Shpenzimet për paga dhe mëditje për vitin 2016 ishin 14,323,589€ apo 99% e buxhetit për këtë kategori.

Çështja 13 - Vonesa në evidentim në listën e pagave dhe mangësi tjera - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Gjatë rishikimit të procedurave të rekrutimit kemi vërejtur se në dy (2) raste të punësuarit e rinj, nuk ishin evidentuar me kohë në sistemin e pagave. Ne sistemin e pagave ishin futur në muajin vijues pas muajit që janë punësuar;
- Në katër (4) raste kemi vërejtur se ekziston një mos harmonizim mes kodeve të programit, gjegjësisht drejtorive me rastin e ekzekutimit të pagave.
- Rreziku** Mos evidentimi i të punësuarve të rinj me kohë në sistemin e pagave mund të rezultojë me keq kalkulime gjegjësisht me pagesa të dyfishta. Mos pagesa e pagave nga programi adekuat rezultojë me nënvlerësimin e njërit program dhe mbivlerësimin e tjetrit.
- Rekomandimi 13** Kryetari duhet të sigurojë që të gjithë të punësuarit paguhen nga fondet e pagave të drejtorive përkatëse, respektivisht kodeve adekuate, si dhe të punësuarit evidentohen me kohë në sistemin e pagave.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2016 ishte 2,998,183€. Prej tyre ishin shpenzuar 2,993,220€ apo rreth 100% nga buxheti i ndarë për këtë kategori. Obligimet e papaguara për mallra dhe shërbime në fund të vitit 2016 ishin 649,978€, duke tejkaluar buxhetin e ndarë për këtë kategori.

Çështja 14 - Paradhënie për komunalni - Prioritet i Lartë

E gjetura Me rastin e testimin të një pagese në vlerë 25,000€ për shpenzime komunale për shkollat e Komunës së Ferizajt, kemi vërejtur se 13 fatura në shumë 19,064€ ishin paguar si paradhënie. Komuna nuk mbanë evidencë për obligimet e pritura nga shpenzimet komunale. Kompania "Pastërtia" kishte faturuar në shuma të ndryshme pa specifikuar se shuma e faturuar i takon muajit aktual apo është borxh paraprak. Kjo ka bërë që zyrtarët të mos i kushtojnë rëndësi dhe të paguajnë këto fatura pa pasur njohuri se çfarë po paguajnë.

Rreziku Mungesa e evidencës për borxhet ndaj kompanisë "Pastërtia" dhe mangësia në kontrollet e brendshme ka ndikuar që komuna të paguaj çdo shumë të faturuar si avanc. Nëse nuk bëhen barazime me faturat e pranuar dhe obligimet ndaj kompanisë, ekziston rreziku për manipulim me paranë publike.

Rekomandimi 14 Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët financiar do të kenë aplikojnë kontrolle të shtuara si dhe mbajnë evidenca të sakta për të gjitha obligimet e pritura, të verifikojnë se cilës periudhë i takon borxhi i faturuar, dhe në rastin konkret, të bëjnë barazimin e faturave me pagesat e komunës ndaj kompanisë në fjalë.

Çështja 15 - Furnizimi me material zyre kryesisht me çmime të larta - Prioritet i mesëm

E gjetura Me datën 17.11.2016 është pagur shuma prej 5,007€ në emër të furnizimit me material për zyre. Ne kemi rishikuar gjashtë (6) fatura të paguara në vitin 2016 prej të cilave një faturë ishte e vitit 2015. Sipas analizës së artikujve të furnizuar në gjashtë (6) faturat e testuara kemi vërejtur se komuna ishte furnizuar vetëm me tetë (8) artikuj, nga 80 që ishin pjesë e kontratës. Këta 8 artikuj ishin të dallueshëm me çmim, ndërsa artikujt e pa furnizuar ishin me çmime 0.01 € apo 0.02 €.

Rreziku Mungesa e kontrolleve ka bërë që komuna të përgatis specifikacionin teknik me shumicën e artikujve të panevojshëm dhe të mundësoj që operatorët të konkurrojnë me çmime jo të arsyeshme dhe jo sipas tregut. Specifikimi i artikujve me të cilët komuna nuk furnizohet asnjëherë, rrit mundësinë e manipulimit me çmime, të cilat janë determinuese për fitimin e kontratave.

Rekomandimi 15 Kryetari duhet të sigurojë se para fillimit të procedurave të prokurimit, zyrtarët përgjegjës marrin parasysh kërkesat dhe nevojat reale të komunës. Artikujt të cilët nuk do të jenë subjekt furnizimi, nuk duhet të përfshihen në dosjen e tenderit.

Çështja 16 - Shpenzime për shërbime të veçanta - Prioritet i lartë

E gjetura Numri i të angazhuarve përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta për vitin 2016 ishte 128, dhe për ta janë paguar 159,138€. Edhe pse që nga shatori 2015 është në fuqi ligji i ri për të ardhurat personale i cili kërkon që punëdhënësi të mbaj tatimin në burim për punonjësit e vet, ne nuk kemi gjetur dëshmi se komuna ka përmbushur këtë kërkesë ligjore.

Rreziku Komuna mund të jetë subjekt i ndëshkimeve nga autoritetet tatimore si pasojë e mos ndaljes së tatimit në burim për personat e angazhuar përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta.

Rekomandimi 16 Kryetari duhet të sigurojë se mbajtja e tatimeve në burim për personat e angazhuar përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta është në harmoni me legjislacionin e aplikueshëm në fuqi.

Çështja 17 - Mospërputhje në raporte për mirëmbajtjen e rrugëve të komunës - Prioritet i lartë

E gjetura Në dy pagesa të kryera për mirëmbajtje të rrugëve të qytetit në vlerë totale 66,712€ ka mos përputhje në përshkrimin e punëve të kryera. Në faturë punët janë përshkruar si heqje e mbeturinave për institucionet, ndërsa në raportin e pranimit shkruan për punët e kryera për pastrimin e rrugëve të qytetit për sezonin dimëror-veror. Ne nuk kemi qenë në gjendje të konstatojmë se çka është pastruar në të vërtetë. Kjo kontratë ishte lidhur me datë 11.08.2015 në shumë 33,356 për njësi. Në pikën 3 të kontratës është përshkruar se vlera e parashikuar për një vit është 150,000€, ndërsa kjo shumë është tejkuluar pas 5 muajve të kontratës.

Rreziku Çertifikimi i pagesave pa pasur dokumentacionin e kompletuar si dhe mos vlerësimi i kostos vjetore të shërbimeve rrit rrezikun që komuna të shpenzojë përtej planifikimit të buxhetit për mirëmbajtje dhe të ketë deficite në kryerjen e pagesave për këto shërbime.

Rekomandimi 17 Kryetari duhet të shtojë kontrollet dhe sigurojë se pagesat bëhen vetëm pasi të konfirmohet se shërbimet e faturuara janë kryer nga ana e operatorit, si dhe të sigurohet paraprakisht se fondet buxhetore janë në dispozicion dhe të parashikuara me planin vjetor.

Çështja 18 - Mungesa e raporteve për shpenzime të naftës – Prioritet i lartë

Rreziku Më datën 22.02.2016 ishin paguar 6,464€ shpenzimet e karburantit për vetura të komunës. Kjo pagesë ka përfshirë shtatë (7) faturat e vitit 2015. Me rastin e rishikimit të faturës së datës 31.08.2015 kemi vërejtur se brigada e zjarrfikësve kishte harxhuar 1,565 litra për një muaj apo 52 litra në ditë. Sipas një parallogaritje kemi vërejtur se vetëm automjeti i ashtuquajtur Volvo është furnizuar për këtë muaj 450 litra. Ne nuk kemi gjetur ndonjë përkrahim për aktivitetin e këtij automjeti. Mungesa e raporteve për aktivitetet e kryera për çka ishin shpenzuar derivatet e naftës, mund të ketë si rrezik që shpenzimet e ndodhura të mos justifikohet me shërbimet e ofruara.

Rekomandimi 18 Kryetari duhet të sigurojë se drejtoria e shërbimeve publike dhe emergjencës do të përgatitë raporte mujore për të gjitha aktivitetet e kryera në mënyrë që shpenzimet e ndodhura të jenë të justifikueshme me shërbimet e kryera.

Çështja 19 - Shpenzimet e reprezentacionit – Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas analizës kemi vërejtur se shpenzimet për dreka zyrtare për vitin 2016 janë 43,060€ apo 97% më shumë se në vitin paraprak. Gjatë testimit të tri (3) pagesave gjithsej me vlerë 6,150€, ne kemi vërejtur se këto fatura i takonin viteve 2012, 2014 dhe 2015. Njëra nga faturat në vlerë 2,491€ në emër të shpenzimeve të reprezentacionit për Drejtorinë për kulturë, nuk kishte të specifikuar qëllimin e drekës. Nuk është e qartë pse këto fatura kanë qëndruar të pa paguara për kaq shumë kohë.

Rreziku Shpenzimet për dreka zyrtare pa arsyetim të qartë të organizimit, shton rrezikun që Komuna të paguajë për aktivitete që nuk përkojnë me objektivat e saj apo që nuk janë kryer fare, dhe fondet publike të shpenzohen në mënyrë jo racionale. Për më tepër, pagesat e kryera disa vite më vonë, ngrisin dyshime serioze që ato të jenë fiktive dhe të mos kenë ndodhur fare.

Rekomandimi 19 Kryetari duhet t'i forcojë kontrollet me rastin e shpenzimeve për dreka zyrtare. Të gjitha shpenzimet për dreka zyrtare duhet të jenë në funksion të mirëfilltë të përfundimit dhe shërbejnë për arritjen e objektivave të komunës. Po ashtu, duhet të sigurohet se obligimet paguhen brenda 30 ditëve.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 670,226€. Prej tyre ishin shpenzuar 659,232€. Shuma 532,798€ ishte shpenzuar për subvencione për entitete publike dhe jo publike ndërsa shuma 126,434€ ishte shpenzuar si transfere mjetesh për përfitues individual.

Çështja 20 - Pagesa nga kodi i gabuar - Prioritet i lartë

- E gjetura** Gjatë testimit të dy (2) pagesave në vlerë totale 49,292€ për furnizimin e fermerëve me fidane të mjedrave dhe sistemit të ujitjes pikë-pikë, kemi vërejtur kishte keq klasifikim të shpenzimeve. Këto pagesa ishin ekzekutuar nga kategoria subvencione dhe transfere, ndërsa do të duhej të paguheshin nga transferet kapitale.
- Rreziku** Klasifikimi i gabuar rezulton me prezantim jo të vërtetë të shpenzimeve për kategori, e në këtë rast ka rezultuar me nënvlerësim të subvencioneve dhe mbivlerësim të shpenzimeve kapitale.
- Rekomandimi 20** Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha shpenzimet regjistrohen në kategoritë përkatëse, në këtë mënyrë do të sigurojë prezantim të saktë dhe pasqyrë të qartë të shpenzimeve.

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 8,341,399€. Prej tyre ishin shpenzuar 6,750,469€. Komuna e Ferizajt në vitin 2016 ka zhvilluar 237 aktivitete të prokurimit dhe vlera e 237 kontratave të lidhura arrin shumën 18,424,337€. Në këtë raport të kontratave të nënshkruara përfshihen edhe kontrata dy dhe tri vjeçare.

Çështja 21 - Sigurimi i tenderit jo sipas kushteve të kontratës - Prioritet i lartë

- E gjetura** Gjatë rishikimit të dosjes së tenderit për projektin e asfaltimit të rrugës në fshatin Mirasal në shumë 286,333€, ne kemi gjetur se kërkohej që fituesi para nënshkrimit të kontratës duhet të paguante sigurimin e ekzekutimit prej 10% nga vlera e kontratës për periudhën e përmbushjes së projektit. Edhe pse ky projekt ishte dy (2) vjeçar, sigurimi i ekzekutimit është bërë vetëm për tre (3) muaj. Raste të tilla janë identifikuar edhe në tetë (8) dosjet tjera të rishikuara.
- Rreziku** Prokurimi ka dështuar në respektimin e kriterëve të tenderimit. Fakti se sigurimi i ekzekutimit nuk është në përputhje me kushtet e parapara të dosjes së tenderit dhe kushteve të veçanta të kontratës (pika 22.1) rrit rrezikun që komuna të mos ketë mundësi ta konfiskoj sigurimin e ekzekutimit në rast të mos përmbushjes së kontratës nga ana e operatorit ekonomik.
- Rekomandimi 21** Kryetari duhet të sigurojë se zyra e prokurimit zbaton të gjitha rregullat e prokurimit duke pasur parasysh se mos respektimi i tyre mund të ndikoj në mos arritjen e objektivave të komunës për projektet kapitale, apo mund edhe të rezultojë mos humbje financiare.

Çështja 22 - Tërheqja e sigurimit të tenderit – Prioritet i lartë

- E gjetura** Me rastin e rishikimit të projektit “Asfaltimi i rrugëve” në fshatin Mirasal, ishte lidhur kontratë me operatorin ekonomik në shumë 286,333€ si ofertues më i shtrenjtë se operatori tjetër me ofertë 266,306€. Shkaku i shpërblimit të ofertuesit më të shtrenjtë ishte se ofertuesi më i lirë kishte tërhequr dosjen e tenderit nga tenderimi pas procesit të hapjes së ofertave. Rast i tillë i shpërblimit të ofertës më të shtrenjtë si rezultat i tërheqjes nga tenderimi pas procesit të hapjes së ofertave ishte edhe tek projekti “Asfaltimi i rrugëve” në fshatin Gaçkë ku kontrata ishte lidhur në shumë 244,300€ apo 33,518€ më e lartë se oferta më e lirë.
- Rreziku** Mos konfiskimi i sigurimit të tenderit (sipas nenit 57 të Ligjit të Prokurimit Publik) në rastet e cekura është shmangie e rregullave të prokurimit në njërën anë, dhe në anën tjetër, komuna ka pasur humbje financiare për kontratat me vlera më të larta se ofertuesit më të lirë.
- Rekomandimi 22** Kryetari duhet të kërkojë përgjegjësi ndaj zyrës së prokurimit për mos zbatimin e rregullave të prokurimit dhe të sigurojë se në rastet e tilla kur një operator terhiqet nga tenderimi, të konfiskohet sigurimi i tenderit nga komuna.

Çështja 23 – Pagesë jashtë llogarisë së operatorit kontraktues – Prioritet i lartë

- E gjetura** Në një (1) rast kemi gjetur se fatura në shumë 30,000€ nuk ishte paguar në llogari të OE fitues, por në një llogari të një kompanie tjetër. Sipas zyrtarit të prokurimit kjo është bërë ngase operatori i njëjtë i ka dy firma. Sipas rregullave financiare pagesa duhet të ekzekutohet në llogarinë e prezantuar nga kontraktuesi kur kontrata është nënshkruar.
- Rreziku** Pagesat e tilla mund të rezultojnë me manipulim të mundshëm të parasë publike. Mungesa e kontroleve ka pasur si rezultat mos ekzekutimin e pagesës në llogarinë përkatëse të operatorit ekonomik. Kjo mënyrë e pagesës mund të ketë si rrezik potencial që të bëhen pagesa të dyfishta për të njëjtën punë.
- Rekomandimi 23** Kryetari duhet të shqyrtoj pse pagesa e tillë ka ndodhur, dhe të sigurojë se zyrtari çertifikues nuk çertifikon asnjë pagesë në llogari jo përkatëse, apo që nuk është pjesë e kontratës, dhe se raste të tilla nuk përsëriten.

Çështja 24 - Ndryshimi i mëvonshëm i kërkesave për aftësi ekonomike dhe teknike - Prioritet i lartë

E gjetura Për tenderin “Zgjerimi i rrugës Komogllavë - Tërstenik, komuna kishte bërë njoftimin për kontratë më 20.07.2016. Të njëjtin tender më 10.08.2016 komuna e kishte anuluar me arsyen që janë bërë gabime në paramasë. Anulimi ishte bërë para hapjes së ofertave, sipas nenit 62 të LPP-së. Më 17.08.2016, ishte bërë njoftimi për ri-tender. Me rastin e krahasimit të dokumentacionit teknik të tenderit të parë dhe ritenderimit, kemi vërejtur se paramasat ishin identike dhe nuk vërehet ndonjë ndryshim. Por, ndryshimet ishin bërë në rritjen e kërkesave të kapacitetit ekonomik dhe financiar dhe kapacitetit teknik dhe profesional. Kërkesa për kapacitetin ekonomik dhe financiar fillimisht ishte që OE të ketë qarkullim financiar jo më pak se 1,500,000€ për tri vitet e fundit, ndërsa në ri-tenderi ishte rritur në jo më pak se 2,000,000€. Ndërsa, kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional në tenderin fillestar ishin së paku tri projekte të ngjashme në tri vitet e fundit, të cilave në ri-tender u kishte caktuar edhe vlera 1,500,000€.

Rreziku Anulimi i tenderit me arsyen e gabimeve në paramasa, dhe ndryshimet e bëra në elementet tjera të kushteve dhe kriterëve të dosjes së tenderit, tregon për paqartësi të procesit dhe rritë rrezikun që si pasojë e këtyre ndryshimeve, operatorët ekonomik të diskualifikohen, e rrjedhimisht konkurrenca të zvogëlohet.

Rekomandimi 24 Kryetari duhet të siguroj se shërbimi i prokurimit do t’iu përmbahet në mënyrë strikte kërkesave të LPP dhe jo të ndryshoj kushtet dhe kriteret e dosjes së tenderit të cilat me rastin e anulimit të tenderit të parë, nuk ishin theksuar si arsye për anulimin e procesit. Kryetari duhet të vendos kontrole të forta në fushën e prokurimit dhe të mundësoj një proces transparent dhe konkurrues të prokurimit, në mënyrë që të maksimizoj vlerën për para.

Çështja 25 - Pagesa për financim të bizneseve – Prioritet i lartë

- E gjetura** Me rastin e rishikimit të pagesës prej 75,000€ kemi gjetur se një pagesë e datës 05.10.2016 ishte bërë në llogari të bashkëfinancuesit “Fondacioni Kosova Luxemburg” me qëllim të mbështetjes së bizneseve të komunës së Ferizajt. Edhe pse komuna kishte derdhur mjetet në llogari të këtij bashkë financuesi, ne nuk kemi gjetur ndonjë raport se është kryer ndonjë aktivitet për bizneset e komunës.
- Rreziku** Mungesa e raporteve se bashkë financuesi ka kryer ndonjë aktivitet, rritë rrezikun që bizneset të mos përfitojnë nga ndihmat e komunës dhe komuna të ketë humbje të pa arsyeshme të parasë publike.
- Rekomandimi 25** Kryetari duhet të eliminoj rrezikun që paraja publike të shpenzohet në mënyrë jo të duhur dhe të sigurojë se pagesat e tilla monitorohen nga zyrtarët financiar dhe se asnjë pagesë nuk ekzekutohet pa pranuar raporte për aktivitetet e kryera.

Çështja 26 - Pagesat sipas marrëveshjeve për bashkëfinancim – Prioriteti i lartë

- E gjetura** Në vitin 2016, Komuna kishte paguar shumën 531,925€ në llogari të OJQ “Caritas” si bashkë financues në tri projektet e fituara për: (1) Ngritjen e kujdesit shëndetësor shtëpiak, (2) Funkcionalizimin e kopshtit në lagjen e re, dhe (3) Funkcionalizimin e qendrës sociale për komunitetin RAE. Ne kemi gjetur se vetëm shuma 280,175€ ishte paguar nga kategoria për mallra dhe shërbime deri sa pjesa tjetër 251,750€ ishte paguar nga kategoria për investime kapitale, duke vazhduar edhe këtë vit me keq klasifikim të shpenzimeve, edhe pse me buxhet ishte aprovuar gabimisht nga kjo kategoria.
- Rreziku** Pagesa e shpenzimeve për paga e mëditje dhe mallra e shërbime nga kategoria e investimeve kapitale, mund të ketë ndikim negativ në plotësinë, cilësinë dhe saktësinë e raporteve financiare të ofruara. Pagesat, si të tilla, janë të klasifikuara gabim dhe mund të rezultojnë me theksim të çështjes.
- Rekomandimi 26** Kryetari duhet të përmirësoj procesin e planifikimit dhe të sigurojë monitorim të këtyre marrëveshjeve që nga inicimi deri në realizimin e plotë të tyre për të parandaluar pagesat për mallra dhe shërbime nga buxheti për investime kapitale.

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Gjatë vitit 2016 Komuna ka bërë një progres të dukshëm në aspektin e regjistrimit të pasurive në krahasim me vitin paraprak. Përkundër progresit, ende nuk është arritur që regjistri kontabël i pasurive të jetë i plotë dhe i saktë. Mos regjistrimi i plotë i pasurisë është trajtuar tek pjesa e Theksimit të Çështjes në Opinion, ndërsa në vijim do të paraqiten disa çështje tjera, të cilat komuna do duhej t'i merrte parasysh në vitin 2017.

Çështja 27 - Mos përdorimi i E-pasurisë dhe mungesa e depozës - Prioritet i lartë

E gjetura Komuna e Ferizajt nuk e përdorë softuerin “e-Pasuria” për t'i regjistruar pasuritë jo financiare nën 1,000€ dhe stoqet. Po ashtu, zyrtari i pasurisë nuk ka një regjistër të përgjithshëm të kësaj pasurie.

Duke pasur parasysh mungesën e një depoje, ne kemi vërejtur se komuna nuk aplikon një sistem të hyrje/daljeve të materialit për zyrë. E vetmja mënyrë të cilën e aplikon komuna është aprovimi i kërkesës për çdo drejtori nga drejtori, deri sa zyrtari pranues vetëm i nënshkruan sasinë e pranuar, duke mos ditur se malli është futur në komunë.

Rreziku Mos funksionalizimi i sistemit e-pasuria dhe mungesa e një depoje, ka bërë që furnizimi të bëhet i decentralizuar nga vetë drejtoritë, duke e rritur rrezikun që zyrtari për pranim të mallit të nënshkruaj pa u siguruar se malli është pranuar. Kjo rrit mundësinë e manipulimit dhe keq përdorimit të materialeve për nevoja zyrtare.

Rekomandimi 27 Kryetari duhet të sigurojë se e-pasuria është funksionalizuar apo regjistrimet e pasurisë në përdorim të mbahen ndonjë formë tjetër, si dhe caktimi i një depoje ku personi përgjegjës do të deponoj mallin dhe do mbajë evidenca për të gjitha hyrje/daljet e materialit për zyrë, duke zvogëluar kështu mundësinë për manipulime të mundshme.

3.2.2 Te arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme të komunës prezantojnë shuma të mjeteve që qytetarët dhe organizatat i detyrohen komunës për shërbimet, punët, mallrat apo pronat që i kanë përfituar nga komuna. Sipas shënimeve të prezantuara në PFV shuma totale e këtyre llogarive në fund të vitit 2016 ishte 6,988,230€.

Çështja 28 - Rritja e vazhdueshme e borxheve të pa mbledhura - Prioritet i lartë

E gjetura Edhe pse të hyrat nga tatimi në pronë përbëjnë pjesën më të madhe të të hyrave vetjake, ato në fund të vitit 2016 kanë rezultuar me një borxh të pa arkëtuar prej 6,237,410€. Rast tjetër me rëndësi ishte edhe me borxhet nga qiraja kur një qiramarrës vite me radhë nuk paguan asnjë cent në llogari të komunës. Shuma e borxhit të pa paguar nga ky qiramarrës ishte 202,560€.

Rreziku Mungesa e një strategjie për inkasim më të mirë të të hyrave, ka rezultuar me rritjen e të arkëtueshmeve nga viti në vit. Prandaj, planifikimi i dobët i të hyrave dhe shkalla e ultë e inkasimeve ka ndikime direkte në realizimin e objektivave të përgjithshme të komunës, e në veçanti realizimin e projekteve kapitale nga të hyrat.

Rekomandimi 28 Kryetari duhet të ketë një qasje gjithëpërfshirëse në trajtimin e këtij problemi, duke vendosur mekanizma efektiv për reduktimin e këtyre borxheve. Menaxhmenti duhet të inicioj një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse, mundësive reale për inkasim dhe ushtrimin e masave administrative (nëse ka nevojë).

3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnizuesve në fund të vitit 2016 ishte 1,038,129€, deri sa në vitin 2015 ishin 1,504,690€. Pra, vërehet një ulje prej 466,561€. Po ashtu, në fund të vitit janë prezantuar detyrimet kontingjente si konteste gjyqësore në shumë 2,653,930€ deri sa në vitin paraprak ishin 2,557,810€. Sipas analizës së llogarive të pagueshme, kemi vërejtur se komuna në vitin 2016, ka paguar gjithsej 1,477,681€ fatura të papaguara të viteve 2011-2015.

Çështja 29 - Menaxhim i dobët i detyrimeve - Prioritet i lartë

Komuna nuk kishte pasur një plan të mirëfilltë të rrjedhës së parasë për pagesën e obligimeve të ndodhura. Në fund të vitit 2016 ishin regjistruar obligime nga kategoria mallra dhe shërbime në shumë 649,978€ deri sa shuma e mbetur e buxhetit për këtë kategori ishte 4,963€. Po ashtu, obligimet për komunalitë kishin tejkaluar buxhetin ngase obligimet e mbetura te papaguara në fund të vitit ishin 96,924€. Sipas vendimeve gjyqësore dhe aplikimit të nenit 39.2 të LMFPJ janë ekzekutuar pagesa në shumë 618,164€ si dhe vendime gjyqësore në shumë 123,717€, si shlyerje e borxheve ndaj operatorëve ekonomik. Sipas rregullave financiare çdo faturë pas pranimit, duhet që brenda 30 ditësh t'i paguhet furnitorit. Komuna nuk ka zbatuar kërkesat e rregullores.

Rreziku

Hyrja në obligime përtej ndarjeve buxhetore dhe mos planifikimi i mirëfilltë i kategorive ekonomike, bartë rrezikun që një pjesë e buxhetit e vitit aktual të shpenzohet për obligimet e mbetura nga viti i kaluar si dhe obligimet të barten nga viti në vit. Gjithashtu, ekzekutimi i pagesave nga gjykatat dhe Thesari, ndikon në çrregullimet e bilanceve buxhetore dhe projektet e planifikuara të mos realizohen.

Rekomandimi 29

Kryetari duhet të sigurojë një planifikim të kujdesshëm dhe real të buxhetit dhe se shfrytëzimi i fondeve të bëhet në bazë të një plani të qartë të rrjedhës së parasë, duke mos tejkaluar në asnjë rast fondet e alokuara sipas kategorive ekonomike. Gjithashtu, të kërkojë më shumë përgjegjësi nga zyrtarët përgjegjës që pagesat e obligimeve të kryhen brenda afateve ligjore.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.4 Pasqyrat Financiare Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim	Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për mos adresimin e rreziqeve domethënëse lidhur me keqklasifikimin e shpenzimeve dhe plotësinë e pasurive e që ka rezultuar me Theksim të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime shtesë për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për të siguruar një vlerësim të saktë të pasurive kapitale. Ky proces duhet të monitorohet formalisht nga Kryetari i Komunës..		Vetëm pjesërisht është zbatuar ky rekomandim ngase edhe në këtë vit ka pasur keqklasifikim të shpenzimeve	
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak	Kryetari duhet të sigurojë se një plan i veprimit i rishikuar qartë i adreson të gjitha rekomandimet të dhëna brenda një afati të caktuar kohor me personat kyç përgjegjës. Procesi duhet të monitorohet në bazë periodike direkt nga ana e Kryetarit.	Po		
2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së	Kryetari duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës			Nuk janë marrë masa për të konfirmuar se vetëvlerësimi është bërë në mënyrë me reale dhe me dëshmi përkatëse.
2.5.1 Vlerësimi i rrezikut	Kryetari duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtor përkatës dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë dhe se rreziqet janë nën kontroll			Nuk janë marrë masa për vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve

2.5.2 Raportimi Menaxherial	Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme deri në fund të vitit 2016			Nuk janë marre masa nga menaxhmenti për një raportim më të mirë financiar dhe operativ nga të gjithë zyrtaret kyç te komunës.
2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë që NjAB të ketë një fokus të shtuar të auditimit në fushat me rrezik të lartë. Komiteti i Auditimit duhet të shtojë kontributin në ngritjen e nivelit të implementimit të rekomandimeve dhe në rishikimin e planeve të NjAB-së	Po		
3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore për investime kapitale monitorohet në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.		Pjesërisht është zbatuar ngase ende mungon një planifikim i duhur për projektet kapitale.	
3.4 Prokurimi	Kryetari duhet të sigurojë se planifikimi dhe analizat e duhura të projekteve janë kryer paraprakisht dhe se janë rishikuar të gjitha paramasat dhe parallogaritë për projekte kapitale, në mënyrë që shmangiet e projekteve nga projeksionet fillestare të jenë minimale.	Po		
	Kryetari duhet të ndërpres praktikatat e nënshkrimit të kontratave pa përfillur procedura të prokurimit. Po ashtu, duhet të inicioj procedurat për hartimin e një politike/rregullore të brendshme për përdorimin e telefonave dhe të përcaktoj limitet e lejuara të shpenzimeve	Po		

	Kryetari duhet të siguroj se zyrtarët janë përgjegjës për respektimin e të gjitha rregullave financiare dhe të kërkojë nga të njëjtit t'i respektojnë rregullat financiare.	Po		
	Kryetari duhet të sigurojë se do të bëhet një rishikim i këtyre gjetjeve të auditimit në të cilat proceset nuk janë aplikuar në mënyrë efektive, si dhe të aplikoj me shumë kontrolle si në rastet e pagesave dhe të kërkoj mbajtjen e dëshmive të udhëtimit bazuar në agjendat paraprake			Nuk është implementuar dhe nuk janë marrë masa konkrete.
	Kryetari duhet të siguroj se të gjitha njësitë kërkuese me rastin e planifikimit të shpenzimeve të kryejnë analiza të plota sepse një planifikim jo i mirë mund të sjellë një konkurrencë jo të mirëfilltë nga ofertuesit, dhe paraja publike të mos shpenzohet në mënyrë racionale.		Pjesërisht është zbatuar ngase ka pasur përsëritje kur ofertuesit me te lire janë eliminuar.	
3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Kryetari duhet të siguroj se marrëveshjet realizohen ashtu siç palët janë dakorduar paraprakisht dhe subjekti i marrëveshjes është baza mbi të cilën kryhen të gjitha pagesat e më vonshme. Të gjitha pagesat duhet të bëhen vetëm pas kryerjes së shërbimeve dhe pagesat në avance duhet të ndërpriten pasi përmbajnë elemente të pagesave të parregullta. Kontrollat e monitorimit të këtyre marrëveshjeve duhet të aplikohen që nga inicimi deri në realizimin e plotë të këtyre marrëveshjeve për të parandaluar pagesat për mallra dhe shërbime nga buxheti për investime kapitale dhe raportet e plota duhet të dokumentojnë arsyeshmërinë dhe rregullsinë e këtyre shpenzimeve.		Pjesërisht është zbatuar ky rekomandim. Në proces të zbatimit ishin ato për kontrata ne vepër.	

	Kryetari duhet t'i forcojë kontrollet me rastin e shpenzimeve për dreka zyrtare. Të gjitha shpenzimet për dreka zyrtare duhet të jenë në funksion të mirëfilltë të përfaqësimit dhe shërbejnë për arritjen e objektivave të komunës. Kryetari duhet ta inicioj hartimin e një procedure e cila përcakton limitet e lejuara dhe rregullat me rastin e shpenzimeve për dreka zyrtare.			Nuk ishte zbatuar dhe nuk janë ndërmarrë masa konkrete.
	Kryetari duhet të siguroj se burimet njerëzore që janë të punësuar në komunë janë të mjaftueshme për të kryer aktivitetet operative të komunës. Kontrollat lidhur me angazhimin dhe monitorimin e këtyre punëtorëve duhet të forcohen dhe njëkohësisht të shqyrtohet mundësia për shtimin e punëtorëve të karrierës për pozitat kyçe të komunës.	Po		
3.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Kryetari duhet të rishikoj funksionimin e kontrollit të listës së pagave dhe të analizojë arsyet që i kanë shkaktuar këto parregullsi të identifikuar. Kryetari duhet të sigurojë që të forcohen kontrollet e listës së pagave për të mundësuar aplikimin efikas të rregulloreve relevante.		Pjesërisht është arritur të plotësohet ky rekomandim deri sa ka mbetur në proces kompletimi i dosjeve të personelit.	
3.5.3 Subvencionet dhe Transferet	Kryetari duhet të sigurojë se dhënies së subvencioneve për entitetet publike apo individuale do t'i paraprijnë kriteret dhe procedura të qarta që përputhen me objektivat e komunës. Kontrollat lidhur me këto kritere dhe procedura, duhet të zbatohen dhe monitorohen duke kërkuar dëshmitë e parapara.		Progresi është arritur në plotësimin e shumicës së kriterëve për dhënien e subvencioneve, përveç marrjes kriterit për raportet kthyesë si dëshmi se paraja publike është shpenzuar sipas rregullave përkatëse.	

3.6 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)	Kryetari të sigurojë një vlerësim detal për mos funksionimin me kohë të mekanizmave për të inkasuar borxhet, sidomos atyre të pronës publike. Po ashtu, do të ishte e rëndësishme të analizohet pse kontrollet kanë dështuar lidhur me inspektimet në terren, si dhe nga personat përgjegjës të kërkoj veprime të menjëhershme për shqyrtimin e rasteve të përmendura.			Nuk janë ndërmarra masa konkrete për inkasimin e të hyrave sidomos ato nga parkingjet.
3.7 Pasuritë dhe detyrimet	Kryetari duhet të siguroj se procesi i regjistrimit të pasurisë dhe vlerësimit/tjetërsimit të bëhet në bazë të legjislacionit në fuqi, për t'ju shmangur rreziqeve të keqmenaxhimit, keqpërdorimit dhe ruajtjes jo adekuate të pasurive të komunës.		Përkundër progresit në këtë vit lidhur me regjistrimin e pasurive, ende nuk është e nevojshme që pasuritë e komunës të mbahen në regjistrin e përgjithshëm të pasurive.	
3.7.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve	Kryetari duhet të ketë një qasje gjithëpërfshirëse në trajtimin e këtij problemi, si në kuptimin e planifikimit ashtu edhe në vendosjen e mekanizmave efektiv për reduktimin në nivel të pranueshëm të këtyre borxheve. Menaxhmenti duhet të inicioj një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse, mundësive reale për inkasim dhe ushtrimin e masave administrative.			Nuk janë ndërmarrë masa konkrete për zvogëlimin e llogarive të arkëtueshmeve.

3.7.3 Trajtimi i borxheve	Kryetari duhet të siguroj një planifikim të kujdesshëm dhe real të buxhetit dhe se shfrytëzimi i fondeve të bëhet në bazë të një plani të qartë të rrjedhës së parasë, duke mos tejkalar në asnjë rast fondet e alokuara sipas kategorive ekonomike. Gjithashtu, të kërkoj më shumë përgjegjësi nga zyrtarët përgjegjës që me rastin e planifikimit të buxhetit, të merret parasysh edhe koha e likuidimit të obligimeve.			Nuk janë ndërmarrë veprime konkrete për mos tejkalimin e shpenzimeve bazuar në fondet e alokuara.
Gjithsej	21	6	7	8

Shtojca IV: Letër konfirmimi

REPUBLIKË E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DIREKTORIA E SHËRBIMIT TË PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Datëse	05.05.2017	
Nr. Org. / Org. jed.	Nr. Prot. / Be. Prot.	Nr. Fajese / Be. Strana.
03	107	
Ferizaj - Uroševac		



KOMUNA E FERIZAJT

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data:
Ferizaj 05.05.2017

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Ferizajit, për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Kryetari:
Muharrem Svarqa

